



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 7, datë 10.01.2025

PËR

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI PËR
PROKURORIN, ZOTI YLLI PJETËRNIKAJ”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*më tej, Këshilli*), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar (në mungesë)
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 10.01.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, miratuar me vendimin nr. 407, datë 17.12.2021, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin zoti Ylli Pjetërnikaj”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 149/a, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;
2. Neni 9 i ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;



3. Nenet 164, pika 8 dhe 189, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar;
4. Neni 8 i Rregullores "Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve".

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues Nr. 31, datë 08.01.2025, i Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit;
- ii. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, ai shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Në datë 16.12.2024, protokolluar me nr. 2709, datë 16.12.2024, pranë Këshillit është administruar shkresa datë 16.12.2024, me lëndë "Kërkesë për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit", e prokurorit zoti Ylli Pjetërnikaj.
3. Referuar përmbajtjes së kërkesës si dhe dokumentacionit shoqërues, si dhe dokumentacionit shoqërues, zoti Pjetërnikaj kërkon, lejimin për të ushtruar veprimtari jashtë funksionit si pedagog me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko Administrative, Universiteti "Albanian University".
4. Referuar kërkesës, angazhimi në fjalë përfshin:
 - 2 (dy) orë në javë, çdo ditë Enjte, ora 13.00-15.00, në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko Administrative, Universiteti "Albanian University", semestri i I-rë, për 15 javë në programin e studimit "Bachelor", si pedagog me kohë të pjesshme në lëndën "E drejta penale", Pjesa e Posaçme, në periudhën dhjetor 2024-korrik 2025;
 - 3 (tre) orë në javë, çdo ditë të Premte, ora 17.00-20.00, në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko Administrative, Universiteti "Albanian University", semestri i I-rë, për 15 javë në programin e studimit "Master", si pedagog me kohë të pjesshme në lëndën "E drejta penale", Pjesa e Posaçme e Avancuar, në periudhën dhjetor 2024-korrik 2025.

Pagesa për veprimtaritë e mësipërme do të jetë 3000 lekë/orë mësimore.



5. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë nëpërmjet postës elektronike është kërkuar informacion plotësues nga prokurori, me qëllim verifikimin nëse angazhimi i mësipërm cenon ushtrimin e detyrës së magjistratit, **si pedagog i komanduar pranë Shkollës së Magjistraturës**. Në vijim, nëpërmjet vërtetimit nr. 31, datë 08.01.2025, të Shkollës së Magjistraturës, jemi bërë me dije si vijon:

“Vërtetojmë se Ylli Pjetërnikaj është komanduar si pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, nga radhët e pedagogëve në detyrë me Vendim nr. 211, datë 08.10.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për një afat dy vjeçar.

Në lidhje me kërkesën e tij për angazhimin në veprimtari jashtë funksionit, vërtetojmë që kjo veprimtari nuk cënon ushtrimin e detyrës së tij si pedagog i brendshëm, për sa kohë z. Pjetërnikaj realizon normën mësimore të përcaktuar në programet e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, si dhe cdo veprimtari tjetër mbështetëse në kuadër të zhvillimit të këtyre programeve”.

6. Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit vlerëson se kërkesa e prokurorit zoti Ylli Pjetërnikaj, është e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

7. Nga verifikimet e kryera rezulton se, prokurori Ylli Pjetërnikaj nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
8. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij.
9. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:
- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
 - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit;
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.
10. Shpërblimi për veprimtarinë jashtë funksionit i parashikuar për angazhimin e kërkuesit nuk tejkalon rregullat e zakonshme të tregut dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e

qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Ylli Pjetërnikaj si Pedagog me kohë të pjesshme në lëndët “E drejta penale” Pjesa e Posaçme dhe “E drejta penale”, Pjesa e Posaçme e avancuar, në programet Bachelor dhe Master, Universiteti “Albanian University”, viti akademik 2024-2025.
2. Ky vendim i njoftohet prokurorit Ylli Pjetërnikaj, dhe Shkollës së Magjistraturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.01.2025.

KRYETAR

Mirela Bogdani

